



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:182693  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05429502

E.nr.524/23

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përbarimit të kreditorëve: A.B., të cilën e përfaqëson av Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsim, për pagesën e shumës në emër të shpenzimeve të udhëtimit, të ushqimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë 08.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përbarimore në lëndën E.nr.524/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.524/23, të datës 23/03/2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsim, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:182693, të datës 18.07.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 12/9/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 545.40 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorë.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

E.nr.524/23, më datë 08.03.2024

**GJYQTARI**

Faton Ajvazi